



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 2531/1 prot.

Tiranë, më 13.12.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin *“Për miratimin në parim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federative të Brazilit”*.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 4605/9 prot., datë 03.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 2531 prot., datë 03.12.2024, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin *“Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federative të Brazilit si dhe relacionin shoqërues”*.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektvendimit dhe relacionit shoqërues vërejmë se palë në këtë projekt marrëveshje është Republika Federative e Brazilit.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar (në vijim, *“Ligji”*), si dhe Vendimit Nr.8 datë 31.10.2016 dhe Udhëzimin Nr.41 datë 13.06.2014 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Republika Federative e Brazilit, nuk bën pjesë në kategorinë e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Për rrjedhojë, referuar nenit 8, pika 2, dhe 9 pika 3, të Ligjit, çdo veprim i shkëmbimit të informacionit, pjesë e së cilit janë edhe të dhënat personale, konsiderohet si transferim ndërkombëtar i të dhënave, për të cilin nuk kërkohet autorizim.

Në vijim të sa më sipër, Zyra e Komisionerit identifikon përgjegjësi për tu shprehur në lidhje me përmbajtjen e neneve 6 dhe 7, të projekt-marrëveshjes.

Në lidhje me nenin 6 të projekt-marrëveshjes, me qëllim garantimin e kritereve dhe parimeve të ligjshme të përpunimit të të dhënave personale, referuar nenit 5 dhe 6, të Ligjit, sugjerojmë që në këtë nen, të shtohet një pikë me përmbajtjen e mëposhtme:

“Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale për qëllime të kësaj marrëveshje duhet të kryhet në përputhje me parashikimet e legjislacioneve të shteteve palë për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Referuar nenit 7, të projekt-marrëveshjes, duke marrë në konsideratë nivelin e pamjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale në Republikën Federative të Brazilit, sugjerojmë riformulimin e nenit 7 me përmbajtjen e mëposhtme :

“Neni 7

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale

1. *Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale, kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale të palëve.*
2. *Transferimi i ndërkombëtar i të dhënave personale mund të lejohet në rastet e mëposhtme:*
 - a) *Kur subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin;*
 - b) *Për të mbrojtur interesat legjitim të subjektit të të dhënave, kur legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale të palës që dërgon, e lejon këtë transferim;*
 - c) *Për të shmangur një kërcënim serioz dhe të menjëhershëm për sigurinë publike kur legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale të palës që e dërgon, e lejon këtë transferim;*
 - d) *Për të mbrojtur një interes jetësor të subjektit të të dhënave;*
 - e) *Për qëllime policore, sipas legjislacionit në fuqi vetëm kur është i nevojshëm për parandalimin, hetimin, zbulimin e veprave penale ose për zbatimin e ndëshkimeve penale dhe shteti marrës duhet të garantojë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje për përpunimin e të dhënave personale;*
 - f) *Përfundim nga rregulli i mësipërm i përcaktuar në shkronjën “e”, përbëjnë rastet kur transferimi është i nevojshëm për parandalimin e një krimi;*
 - g) *Përshtatshmëria e nivelit të mbrojtjes, sipas shkronjës “e” të këtij neni, vlerësohet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bazë të rrethanave në të cilat ndodhet procesi i transferimit të të dhënave.”*
3. *Secila palë duhet të garantojë mbrojtjen e të dhënave personale me qëllim zbatimin e kësaj marrëveshje, duke marrë përsipër detyrimin për të mos i transferuar të*

dhënat personale të marra, tek palët e treta, dhe në çdo rast të mos i përpunojë ato, pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, kjo projekt-marrëveshje do të konsiderohet e hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi